



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 48
Prishtinë, më 26 prill 2017, në orën 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-204-

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Faton Topalli, Ali Sadriu, Hajdar Beqa, Synavere Rysha, Naim Fetahu, Bali Muharremaj, Abdyl Ymeri dhe Enver Hoti.

Mungoi: Fikrim Damka.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatorë e Komisionit, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi në Komision, Blendian Telaku, praktikant dhe Mentor Hyseni, GIZ.

Pjesëmarrësit e tjerë: Arsim Bajrami, Agim Berdyna, Ferit Idrizi nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). Bujar Bajraktari, Vlora Mehmeti, Mirlinda Ahmeti dhe Drilon Shala nga ZKA.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.4.2017;
3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Raportin Financiar të Fondit të Bashkuar për Sektorin e Arsimit për periudhën janar-mars 2016. I ftuar ministri i MASHT-it, z. Arsim Bajrami;
4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit dhe Procesi i Rishikimit të Teksteve Shkollore. I ftuar ministri i MASHT-it, z. Arsim Bajrami;
5. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.4.2017

Kryetari konstatoi se procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 19.4.2017, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Raportin Financiar të Fondit të Bashkuar për Sektorin e Arsimit për periudhën janar-mars 2016

Faton Topalli, kryetar, e hapi takimin duke theksuar se KMFP ka vendosur të shqyrtojë raportin e auditimit për Raportin Financiar të Fondit të Bashkuar për Sektorin e Arsimit për periudhën janar-mars 2016. Pasi nuk kishte të gjetura të theksuara në këtë raport, përveç një shumë të mjeteve prej mbi 4,000 euro, e cila ishte shpenzuar në një punëtori në Shqipëri pasi kishte kaluar data e implementimit (mbylljes) së projektit. Me këtë hapi diskutimin.

Përfundim

KMFP vendosi që të përkrahet si i tillë dhe mos të adresohet për Seancë Plenare, Raporti i Auditimit për Raportin Financiar të Fondit të Bashkuar për Sektorin e Arsimit për periudhën janar-mars 2016.

4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit dhe Procesi i Rishikimit të Teksteve Shkollore

Faton Topalli, kryetar, theksoi se ZKA ka përgatitur këtë raport si vazhdimësi e raportit të performancës shpërndarja e teksteve shkollore, nga viti i kaluar, ku ishin konstatuar shumë shkelje si në buxhetim, prodhim, pranim, shpërndarje dhe kthim të Librave. Bazuar në të gjeturat e Raportit të Auditimit dhe Procesi i Rishikimit të Teksteve Shkollore, mundemi me konstatuar se MASHT nuk ka bërë ndonjë avancim në këtë proces. Objektivi i këtij auditimi ishte përmirësimin e pasaktësive shkencore dhe gabimeve në tekstet shkollore. Lehtësimin e çantës së shkollës, dhe kursimet buxhetore për botimin e teksteve shkollore. Që të tria këto objektiva nuk janë realizuar. Analizat e ZKA-së lidhur me këtë objektivë janë orientuar në tri aspekte: Procesi i rishikimit të teksteve shkollore, përbërja dhe kualifikimet e anëtarëve të Këshillit dhe ndryshimet e bëra në tekstet ekzistuese shkollore. Objektivi i dytë lidhur me lehtësimin e çantës nuk është arritur. Këshilli ka sqaruar se ata janë përqendruar në realizimin e objektivit kryesor të tyre i cili kishte të bënte me përmirësimin e mangësive në tekstet ekzistuese shkollore. Procesi i rishikimit, me gjithë mangësitë sipërfaqësore të adresuara për përmbajtjen e teksteve shkollore, ka rezultuar me ribotimin e tërë tirazhit të teksteve shkollore, me gjithsej 94 tekste shkollore. Kjo nënkupton se edhe këtë vit, sikurse edhe vitin e kaluar shpenzimet buxhetore kanë krijuar kosto financiare prej 7 milionë €. Sipas asaj që u tha më lart mund të konkludojmë se ministri i MASHT-it, Qeveria, si dhe Kuvendi, kanë dështuar në realizimin e Objektivave të caktuara nga ana e tyre paraprakisht. Janë botuar tekste të cilat janë vërtetuar se kanë qenë me gabime. Me këtë e hapi diskutimin.

Ali Sadriu theksoi se MASHT kohëve të fundit ka arritur progres në proces të menaxhimit të ndarjes së Librave për nxënësit e shkollave të mesme dhe fillore, ashtu siç kërkohet me Ligjin për Arsimin e Mesëm dhe Fillor. Po ashtu pyeti se a kemi raste kur MASHT, ka arritur të bëjë përkthim të literaturës nga gjuhët e huaja në gjuhën shqipe për nevojat e studentëve.

Bali Muharremaj pyeti se a ka përmirësime të dukshme sa i përket, cilësisë së teksteve shkollore, sepse sipas raportit thuhet se vetëm 8% e Objektivave të MASHT-it, janë përmbushur në këtë objektivë?

Enver Hoti pyeti për Qendrat e Kompetencës në komuna, si dhe rëndësinë e krijimit të Agjencisë për këto Qendra, sa janë arritur objektivat e juaja në funksionalizimin e këtyre qendrave?

Naim Fetahu theksoi se MASHT, ka bërë progres në fushën e arsimit në përgjithësi, e në veçanti për projektin e Blerjes së Librave.

Synavere Rysha theksoi se të dyja raportet të cilat kemi sot në diskutim janë të një rëndësie të veçantë, megjithatë procesi i furnizimit me tekste shkollore ka sfida të ndryshme. Raporti i Auditimit ka bërë një shpalosje të mirë të të gjitha të gjeturave. Përkundër progresit të arritur ky projekt ka edhe lëshimet e veta, të cilat mendojë se në të ardhmen do të eliminohen, kjo me një përkushtim më të madh të vetë MASHT-it.

Hajdar Beqa theksoi se MASHT ka bërë progres në këtë projekt. Po ashtu pyeti se MASHT, në kohën e ndryshimit të udhëzimit administrativ për tekstet shkollore, ka pasur afatin e shkurtër kohor për t'i dhënë vërejtjet për tekstet shkollore nga ana e mësimdhënësve, kjo ka reflektuar më pastaj edhe në mungesën e vullnetit të tyre për t'i paraqitur vërejtjet?

Arsim Bajrami, ministër në MASHT, theksoi se auditimet e bëra këto dy vitet e fundit na kanë ndihmuar ne, si MASHT, me u përmirësuar në shumë aspekte, e në veçanti në projektin e furnizimit me libra për nxënësit e arsimit fillor dhe të mesëm. MASHT ka përgatitur udhëzimin e ri administrativ për shpërndarjen e Librave, përmes këtij udhëzimi MASHT ka nën kontrollim edhe stoqet e librave. Problem në vete është edhe shuma e mjeteve të ndarë për blerjen e librave, pra, ne tani kemi kursim të mjeteve për këtë projekt. Pesha e çantave është një problem në tërë bashkimin evropian, tani në kemi peshën mesatare të librave prej 5 deri në 7 kilogram, ndërsa në shtetet e bashkimit evropian pesha e tyre arrin deri në 11 kilogram.

Agim Berdyna theksoi se MASHT, ka bërë progres në procesin e furnizimit të nxënësve me tekste shkollore, si në cilësi të teksteve, kursim të buxhetit, si dhe në zvogëlim të peshës së vet teksteve. Ndryshimi i udhëzimit administrativ për furnizim dhe shpërndarje të teksteve shkollore na e ka lehtësuar punën në këtë drejtim.

Faton Topalli, kryetar, mbylli diskutimi në këtë pikë me këtë përfundim.

Përfundim

KMFP vendosi që raporti i Auditimit për Procesin i Rishikimit të Teksteve Shkollore, të përkrahet si i tillë, të mos adresohet për Seance Plenare. Megjithatë MASHT të përgatiti planin e veprimit për adresimin e të gjeturave nga raporti i Auditimit.

5. Të ndryshme.

Faton Topalli, kryetar, njoftoi deputetët se GIZ ka dorëzuar listën finale të pjesëmarrësve në vizitën në Gjermani, është një listë tjetër prej asaj që ka propozuar komisioni në mbledhjen e kaluar. Po kërkojmë që përmes përfaqësuesit të GIZ-it, kjo listë të ndryshohet sipas propozimit të komisionit të diskutuar në mbledhjen e mbajtur më 19 prill 2017.

Mbledhja përfundoi në orën 13:20.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Faton Topalli